

Neutraliteti i BE-së, vështirësi shtesë për proceset eurointegruese të Kosovës

*Bashkim Rrahmani**

Abstrakt

Angazhimi i institucioneve të BE-së ka qenë i ndryshëm krahasuar me intervenimin e Brukselit ndaj shteteve tjera të Ballkanit dhe në veçanti lidhur me shtetet që kanë dalë nga procesi i shpërbërjes së ish-federatës jugosllave.

Roli i institucioneve të BE-së ka qenë shumë i rëndësishëm në fazat e para të rindërtimit dhe të ndërtimit të Kosovës pas instalimit të institucioneve civile ndërkombëtare, kur BE kishte një ndër shtyllat kryesore të pushtetit administrativ ndërkombëtar. Megjithatë, në procesin e integriteteve sipas Procesit të Stabilizim-Asociimit, ishin krijuar mekanizma të tjerë që e vendosnin Kosovën në pozitë të ndryshme krahasuar me Maqedoninë, me Malin e Zi, me Serbinë etj. Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, pesë shtete të BE-së nuk e njohën pavarësinë, ndërkohë që institucionet e BE-së vazhdojnë të mbajnë pozitë neutrale ndaj statusit të Kosovës. Këto janë çështje që e kanë ngadalësuar dhe e kanë vështirësuar procesin e integritetit të vendit, kurse Kosova është shteti i fundit që u fut në raporte kontraktuese me institucionet e BE-së. Krahas kësaj, Kosovës i janë vënë edhe kushte shtesë të cilat nuk u ishin parashtruar për vendet tjera të Ballkanit. Këto e kanë vënë Kosovën në pozitë të pabarabartë me shtetet tjera që janë në procesin e integritetit. Punimi bën një analizë të ndërhyrjes së institucioneve të BE-së nëpër faza të ndryshme, përfshirë fazën e shpërbërjes së ish-federatës e deri pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Nëpërmjet analizimit të dokumenteve dhe të

* Prof. Ass. Dr. Bashkim Rrahmani, Kolegji AAB, Prishtinë, Fakulteti i Administratës Publike. Email: bashkim.rrahmani@aab-edu.net

politikave të BE-së shqyrtohet roli i kësaj ndërhyrjeje dhe vështirësitë e integritit të Kosovës në proceset e integritit.

Fjalë kyç: *Kosova, integritet, standard, BE, shpërbërje, federate.*

Kosova është shteti më i ri dhe i fundit që është krijuar nga procesi i shpërbërjes së ish-federatës jugosllave. Jugosllavia është shpërbërë, pos tjerash, nga shkaku i dy orientimeve kryesore të subjekteve përbërëse të saj: shumica që aspironin decentralizim dhe pavarësi e liri nacionale nga hegjemonizmi dhe, pakicës (Serbia), që kërkonte hegjemoni dhe mbisundim. Fatkeqësisht, procesi i shpërbërjes së federatës jugosllave u shoqërua me luftëra, me krime dhe me pasoja që nuk ishin parë në Evropë që nga Lufta e Dytë Botërore. Meqenëse këto pasoja rrezikonin të shpërndareshin edhe jashtë territoreve të ish-Jugosllavisë, bashkësia ndërkombëtare u angazhua në forma dhe me instrumente të ndryshme në mënyrë që në mos tjetër, së paku konflikti të lokalizohej. Ky angazhim nuk ishte me përmbajtje dhe me intensitet të njëjtë në të gjitha njësitë e ish-federatës jugosllave, sikundër që edhe luftërat që shpërthyen në këto territore nuk ishin të përmasave të njëjta dhe të kohëzgjatjes së njëjtë. Lufta në Slloveni ka zgjatur vetëm disa ditë dhe pati numër të vogël të viktimave, kurse luftërat në Kroaci, në Bosnie e Hercegovinë dhe në Kosovë kanë qenë luftëra që kanë shkaktuar krime kundër njerëzimit, për çka persona përgjegjës janë gjykuar nga një Gjykatë Ndërkombëtare. E vendosur në Hague (Hagë), Holandë, gjykata ka ngarkuar me përgjegjësi mbi 160 persona. Të akuzuarit nga gjykata përfshijnë kryetar shteti, kryeministër, komandant ushtrie, ministër të brendshëm dhe shumë liderë politikë, ushtarakë e policorë të niveleve të larta dhe të niveleve të mesme, nga palë të ndryshme të konfliktit jugosllav. Akuzat përfshijnë krimet e kryera nga viti 1991 deri në vitin 2001 ndaj anëtarëve të grupeve të ndryshme etnike në Kroaci, në Bosnjë e

Hercegovinë, në Serbi, në Kosovë dhe në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë (About the ICTY, n.d.).

Parlamenti i Republikës së Kosovës me datë 17 shkurt 2008 ka aprovuar Deklaratën e Pavarësisë, me çka Kosova është shpallur shtet i pavarur dhe sovran. Që nga kjo datë, ka filluar procesi i njohjes së shtetit të Kosovës dhe deri më sot vendi është njohur nga 116 shtete të botës. Edhe nga shtetet e Bashkimit European, Kosova është njohur nga 22 shtete nga gjithsej 27¹ sa i ka Bashkimi European si organizatë supranacionale dhe rajonale europiane.

Angazhimi i BE-së gjatë procesit të shpërbërjes së ish-Jugosllavisë

Angazhimi i bashkësisë ndërkombëtare lidhur me zgjidhjen e konflikteve në fazën e hershme të shpërbërjes së ish-Jugosllavisë nuk ishte i intensitetit të njëjtë në të gjitha njësitë federative dhe nuk jepte propozime të njëjta për to. Në të vërtetë, qëndrimet e bashkësisë ndërkombëtare në fazën e hershme të shpërbërjes së ish-Jugosllavisë ishin për ruajtjen e tërësisë territoriale të saj dhe këto qëndrime nuk përkrahnin shkëputjen e njësive federative nga Jugosllavia. Sa i përket angazhimit të BE-së² e cila në fazën e hershme të shpërbërjes së Jugosllavisë njihej si Komunitet European, ai angazhim ishte, siç u tha, i ndryshëm nga intensiteti dhe nga përmbajtja. Në të vërtetë, procesi i shpërbërjes së federatës filloi në një kohë kur formësimi politik i Evropës ishte ndryshuar në mënyrë

¹ Greqia, Rumania, Qipro, Spanja dhe Sllovakia.

² Bashkimi European sot është një union politik dhe ekonomik, i cili brenda vetes ka 27 shtete me një popullsi që vlerësohet të jetë mbi 500 milionë banorëshe. Si organizatë e këtillë është themeluar me Traktatin e Maastricht-it të vitit 1993. Jepet numri 27 i vendeve anëtare, sepse Britania e Madhe është në proces largimi nga BE-ja.

dramatike kur ra Muri i Berlinit në vitin 1989. Kjo çoi të ribashkimi i Gjermanisë në tetor të vitit 1990 dhe tek ardhja e demokracisë në vendet e Evropës Qëndrore dhe Lindore, të cilat po dilnin nga kontrolli sovjetik. Bashkimi Sovjetik pushoi së ekzistuari në muajin dhjetor të vitit 1991 (Fontaine, 2017,13). Në të njëjtën kohë, shtetet anëtare po negocionin një traktat të ri, i cili ishte miratuar nga krerët e shteteve apo qeverive në Maastricht në dhjetor të vitit 1991. Duke i shtuar bashkëpunimin ndërqeveritar (në fushat si politika e jashtme, drejtësia dhe punët e brendshme) sistemit ekzistues të Komunitetit, Traktati i Maastrichtit krijoi Bashkimin European (BE). Ky traktat hyri në fuqi me 01.11.1993 (Fontaine, 2017, f. 15).

Pikërisht në këtë kohë të ndryshimeve të mëdha, Komuniteti European po riorganizohej dhe po merrte formën e një unioni ekonomik dhe politik. Kurse, me qëllim (pos tjerash) të përgatitjeve për të pasur një bazë legale të njohjes së shteteve të reja, Komuniteti European me datën 16 dhjetor 1991 ka nxjerrë një Deklaratë të emërtuar “Udhëzuesi për njohjen e shteteve të reja në Evropën Lindore dhe në Bashkimin Sovjetik“ me çka është miratuar procesi i njohjes së shteteve të reja. Është bërë e ditur në veçanti se njohja kërkon:

- *respektimin e dispozitave të Kartës së OKB-së si dhe përkushtimin e përshkruar me Aktin Final të Helsinkit si dhe në Kartën e Parisit, në veçanti ato që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit, demokracisë dhe të drejtave të njeriut;*
- *garantimin e të drejtave të grupeve etnike, grupeve nacionale dhe pakicave në pajtim me përkushtimet përshkruar me kornizën e OSBE-së;*
- *respektimin e paprekshmërisë së të gjithë kufijve, të cilët mund të ndryshohen vetëm me mjete paqësore dhe me marrëveshje të përbashkët;*

- *pranimin e të gjitha përkushtimeve relevante lidhur me çarmatimin dhe mospërhapjen e armëve bërthamore si dhe sigurinë e stabilitetin rajonal;*
- *zotimin për të zgjidhur me marrëveshje, përfshirë aty ku mundet burimet e arbitrazhit, si dhe të gjitha problemet lidhur me sukseset e shteteve e mosmarrëveshjeve rajonale (Shaw, 2003, 374-375).*

Në të njëjtën ditë Komuniteti European ka nxjerrë Deklaratën për Jugosllavinë me çka komuniteti dhe shtetet anëtare pajtohen të njohin republikat jugosllave, por kur t'i përmbushin disa kushte të caktuara. Këto ishin kur këto republika dëshironin njohje për të qenë të pavarura, se: pranojnë zotimet e parapara me Udhëzuesin; se do të pranohen dispozitat e parapara me draftkonventën e Konferencës për Jugosllavinë në mënyrë të veçantë të drejtat e njeriut dhe të drejtat nacionale dhe të drejtat e grupeve etnike; përkrahja e dhënë përpjekjeve të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe vetë Konferencës për Jugosllavinë.

Komuniteti dhe anëtarët e vet kanë kërkuar gjithashtu që republikat e veçanta jugosllave që kërkojnë njohje, do të zotohen para njohjes se do të japin garanci kushtetuese dhe politike me çka sigurojnë që nuk do të ketë kërkesa territoriale ndaj shtetit fqinj (Shaw, 2003, f. 375).

Konflikti i armatosur që fillon në Slloveni dhe që vazhdon edhe në pjesën tjetër në Jugosllavi, nuk e merr trajtimin e njëjtë nga Komuniteti European. Diku kishte angazhim më të madhe e diku më të ngadalshëm. Ngjarjet dramatike zhvillohen më shpejt në terren, kurse ndërmjetësimi dhe angazhimi i komunitetit apo BE-së, është në të shumtën e rasteve prapa ngjarjeve dhe prapa tmerreve. Megjithatë, angazhimi dhe intervenimi diplomatik ishte i domosdoshëm. Dhe në këtë kontekst i gjejmë të gjitha format e intervenimit: ndërmjetësimi ndërkombëtar, ofrimi i shërbimeve të mira, arbitrazhi etj. Por, Komuniteti European/BE nuk kishte instrumente të

intervenimit ushtarak, ndërkohë që përmendej edhe parimi i karotës dhe shkopit. Format e intervenimit ishin përmes “trojkave”, përmes sigurimit të komunikimit, kishte edhe tejkalim të autorizimeve sikundër edhe kishim profesorë të demokracisë nga komuniteti ndërkombëtar. Por, ka edhe diçka tjetër. Është interesi i veçantë i shteteve të caktuara për përzierje sipas këndvështrimit apo interesit vetjak shtetëror. Kjo u vu re sidomos gjatë viteve 1990 - 1995. Për Gjermaninë ishte joshja e zgjedhësve të tyre me prejardhje kroate, për Austrinë përfitimi nga pasuritë dhe afritë e shumta me Slloveninë fqinje, për Vatikanin mbështetja e bashkësisë së numërt katolike të Kroacisë (Dufour, 2010, f. 115).

Bashkimi European intervenon përmes misioneve vëzhguese, të cilët konsideroheshin veshë dhe sy të komunitetit europian. E, detyra e tyre ishte mbikqyrje, vëzhgim dhe raportim, por jo rrallë kishte joharmonizim në mesin e ekipeve vëzhguese. E gjithë kjo pastaj dukej sikur të kishim vënë akulloren në Diell (Miškulin, 2013). *Akullore në Diell* sepse iniciativat figurativisht shkriheshin. Duke qenë se konflikti kishte marrë përmasat e luftës shkatërruese, komuniteti europian ishte fokusuar më shumë në Kroaci (e cila ishte njohur si shtet bashkë me Slloveninë, së pari nga Gjermania) dhe në Bosnjë e Hercegovinë, kurse Kosova kishte mbetur të kënaqej me deklarata diplomatike organesh dhe institucionesh të ndryshme ndërkombëtare. Asaj nuk iu mundësua as të ishte pjesë e Konferencës së Paqes të Lordit Carrington dhe gjithashtu nuk iu mundësua as të ishte pjesë e Konferencës së Dayton. Ivica Miskulin ka nënvizuar këto të meta të anagzhimit në Kroaci: mosnjohje të situatës që ka sjellë vonesa rreth ngjarjeve, mungesë të qëndrimeve të përbashkëta-politike të përbashkët, mungesë fleksibiliteti, përdorim të mjeteve joadekuate, kundërshtimi (mospërputhje) i interesave të shteteve anëtare, mosekzistimi i forcave të armatosura, minim i

ndërmjetësimit nga vetë ndërmjetësuesit (Miskulin, 2013). Lënia anësh e konfliktit të ngrirë (në Kosovë) dhe angazhimi përmes deklaratave e rezolutave, megjithatë çoi te shpërthimi i luftës së armatosur, luftë të cilën fatmirësisht e bëri më të shkurtër intervenimi ushtarak i NATO-s.

Kontaktet fillestare kishin të bënin me sensibilizimin e çështjes së Kosovës, me kërkesa për t'u trajtuar në mënyrë të barabartë me përbërësit e tjerë të Jugosllavisë, sigurimin e mbështetjeje në fusha të ndryshme të jetës dhe kërkesa të tjera të kësaj natyre. Kurse, vetë europianët kishin vendosur më 1991 se "të drejtën e shkëputjes nga ish-Federata Jugosllavisë e kishin vetëm republikat, por jo edhe krahinat (Kosova dhe Vojvodina). Vendet europiane nën diktatin e Francës e njohin Serbinë pas Dayton-it (1996) me emrin e vjetër Jugosllavia dhe i dhanë Serbisë dhe Malit të Zi të drejtën që ta trashëgonin emrin e federatës së dikurshme të shkatërruar (Bytyçi, 2012, f. 386).

Kosova ka pasur mbështetje dhe premtime të bukura, si p.sh: ...në prill 1989 Parlamenti Europian kishte shprehur protestën ndaj masave represive. ...më 1993 ai miratoi një rezolutë, të konsideruar si konstruktive në Kosovë, duke i inkurajuar ushtarët të dezertojnë ... rezoluta parashihte pranimin e tyre në shtetet e bashkësisë europiane. ...në shtator 1992 KSBE-ja kërkoi një veprim parandalues të menjëhershëm në Kosovë. ...KSBE-ja bënte presion ndaj autoriteteve të Beogradit për të nisur dialog serioz me përfaqësuesit e Kosovës me praninë e një pale të tretë... Më 27.12.1992 Presidenti Bush, premtoi se SHBA-të nuk do të lejojnë që Kosova të shndërrohet në Bosnje të dytë... kërcënonte Serbinë me sulme ajrore... me 23.02.1993 në Gjenevë, me rastin e paraqitjes së "Planit të Paqes për Kosovën", Komisioni i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut votoi një rezolutë që dënonte shkeljen e të drejtave të njeriut, veçanërisht në Kosovë. Një tjetër rezolutë u votua me 20 gusht ku kërkohet vazhdimi i misionit të KSBE-së... Në maj 1993 në Uashington ministrat e punëve të jashtme, ai amerikan, rus, anglez, francez dhe spanjoll, shprehin vendosmërinë e tyre

sipas të cilës Kosova duhet të gëzojë një autonomi të gjerë... Ata nuk precizonin se mund të merrnin parasysh pavarësinë në rast të vazhdimit të keqtrajtimit të shqiptarëve... 3 shkurt Ibrahim Rugova takoi Presidentin Clinton dhe Al Gore... ata nxisin shqiptarët të vazhdojnë me ndjekjen e politikës paqësor...; 2 nëntor 1994 bashkëkryesuesit e Konferencës Ndërkombëtare për ish -Jugosllavinë, Lordi David Owen dhe Thorwald Stoltenberg, pranuan në takim Ibrahim Rugovën. Ata shprehën simpatinë e tyre për politikën paqësore...; 23 dhjetor 1994 Asambleja e Përgjithshme e OKB-së dënon ashpër masat dhe praktikat diskriminuese si dhe shkeljet e të drejtave të njeriut të shqiptarëve të Kosovës... dënon represionin e shkallës së lartë të praktikuar nga policia dhe nga forcat e ushtrisë së RFJ-së... kërkon vendosmërisht nga autoritetet e RFJ-së t'i lejojë misionet afatgjata të Konferencës për Siguri dhe Bashkëpunim Europian të kthehet menjëherë në Kosovë.... (Dufour, 2010, f. 78-80).

Sidoqoftë dhe për fatin e keq të njerëzve që u vranë, që figurojnë të zhdukur, që pësuan dëme të mëdha materiale e shpirtërore, lufta përfundoi me intervenim ushtarak të forcave të NATO-s, ndërkohë që ishte nxjerrë edhe një Traktat i BE-së, pas atij të Maastricht-it. E paraprakisht, ishin nxjerrë kritere të reja anëtarësimi në vitin 1993. Kështu, për vendet që aspironin aderimin në BE, nga bota e Europës Qendrore dhe Lindore, Këshilli Europian kishte vënë disa kritere të njohura si kriteret e Kopenhagenit. Në bazë të këtyre kritereve, vendet candidate do të gjykoreshin për pranimin në BE dhe që përcaktonin (Dinan, p.d. f. 188):

- Qëndrueshmëri të institucioneve duke garantuar demokracinë, shtetin e së drejtës, të drejtat njerëzore si dhe respektimin dhe mbrojtjen e minoriteteve;
- Ekzistencën e një ekonomie tregu funksionale si edhe të aftë për t'iu përgjigjur presionit konkurrues dhe forcave të tregut të BE-së;

- Aftësi për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit, përfshirë edhe ndjekjen dhe zbatimin e qëllimeve politike, ekonomike dhe monetare të bashkimit.

Por, Kosovës, krahas kësaj do t'i shtohen edhe kushte tjera, madje kushte që asnjë vendi nuk i janë parashtruar për t'u plotësuar.

Angazhimi i BE-së në kohën pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë

Nuk mund të thuhet se Kosova do të ndërtonte shtetin e vet të pavarur dhe të çlirohej vetë në luftën e viteve të fundit të shekullit 20, pa angazhimin e bashkësisë ndërkombëtare dhe pa angazhimin e Bashkimit European. Sigurisht se roli më i fuqishëm për çlirimin e Kosovës ka qenë angazhimi i SHBA-ve dhe i forcave të NATO-s, angazhim ky që nuk është objekt i këtij shqyrtimi të shkurtër.

Pas përfundimit të luftës dhe pas vendosjes së paqes në Kosovë, Bashkimi European do të luajë rolin kryesor në ndërtimin dhe në rindërtimin e vendit. Është BE që do të marrë Shtyllën IV të UNMIK-ut që kishte të bënte me ndërtimin dhe rindërtimin e vendit. Dhe është po ashtu OSBE që do të udhëheqë shtyllën III të UNMIK që kishte të bënte me demokratizimin dhe me ndërtimin e institucioneve demokratike etj. Natyrisht, krahas kësaj, kontribut i madh është dhënë nga vendet e BE-së edhe në aspekt të sigurisë në Kosovë, në kuadër të forcave paqeruajtëse - KFOR. E gjithë kjo mund të diskutohet, por nuk mund të kontestohet. Mund të diskutohet, sepse Kosova pas luftës përkundër deklaratave të qarta që kanë dalë nga mekanizmat e vendosjes në Evropë, nuk është trajtuar në mënyrë të barabartë me shtetet tjera të rajonit. Madje, sa i përket Kosovës, qëndrimet kanë qenë formalisht dhe përmbajtësisht të ndryshme.

Me 10 qershor 1999 në Këln me iniciativë të BE-së u miratua Pakti i Stabilitetit për Europën Juglindore (www.emins.org). Ishte kjo një ndër ndërmarrjet e mëdha të BE-së (Bytyçi, 2012, f. 399) ku më shumë se 40 vende partnere dhe organizata përkushtohen në fuqizimin e vendeve të Europës Juglindore në përpjekje për të ushqyer paqen, demokracinë, respektimin e të drejtave të njeriut dhe të prosperitetit ekonomik që të arrihej stabiliteti në tërë rajonin. Të gjitha vendeve të rajonit u premtuhej integrimi euroatlantik. Pakti u riafirmua në Samitin e Sarajevës me 30 korrik 1999 (www.emins.org). Edhe pse thuhej se me këtë po punohet për një skenar për përfshirjen e të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor³, megjithatë për Kosovën, nuk po krijoheshin mundësi të barabarta me vendet e tjera të Ballkanit. Për më tepër, tani nga shkaku i mosnjohjes së shtetësisë së Kosovës nga Serbia dhe nga Bosnjë e Hercegovina, Kosova ballafaqohet me vështirësi, të cilat e pengojnë pjesëmarrjen e saj në Këshillin e bashkëpunimit regional [trashëgimtari i Paktit të Stabilizimit] (Forum 2015 - 2013, f. 7). Kosova në këtë kohë administrohej ndërkombëtarisht dhe për shkak se nuk kishte status të përcaktuar, ishte lënë mënjanë, në një kohë kur vendet e tjera të Ballkanit po bëheshin gati për të nënshkruar Marrëveshjet e Stabilizim-Asociimit. Disa edhe kishin nënshkruar. Në aspekt të rindërtimit të Kosovës, Bashkimi Europian kishte nënvizuar nevojën e vendosmërisë për të marrë një rol udhëheqës (www.europarl.europa.eu/summits/kol2_de.htm). Më vonë Kosova do të përfitojë në këtë kuptim edhe nga fondet e Instrumentit të Para-Anëtarësimit (IPA).

Fondet e BE-së për rindërtim dhe zhvillim, por edhe për fushat e tjera të jetës në Kosovë, janë kontribut shumë i çmuar,

³ Kur flitet për Ballkanin Perëndimor me vokabularin e BE-së, mendohet për vendet e dala nga ish-Jugosllavia dhe për Shqipërinë, e ku përjashtohet Sllovenia.

por angazhimi politik i BE-së për të avancuar dhe për të zgjidhur statusin final të Kosovës nuk ka qenë në nivel të nevojave dhe nuk mund të krahasohet me angazhimin e SHBA-ve. Për një kohë të gjatë janë vërejtur hezitime rreth thellësisë së angazhimeve politike drejt Kosovës apo për Kosovën. Këto hezitime vazhduan edhe pas përfundimit të luftës në Kosovë dhe vazhdojnë në forma të ndryshme edhe pas shpalljes së pavarësisë. Edhe pse ishte e qartë që Kosova nuk do të kthehej më në ndonjë krenari serbo - malazeze, nga BE-ja në momente të caktuara, bëhej pikërisht kjo. Madje edhe kur shihej qartazi se bashkëjetesa e Serbisë me Malin e Zi nuk do të kishte gjasa, BE-ja dërgon Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit për Politikë të Jashtme dhe të Sigurisë në Beograd për të ushtruar ndikimin e vet...me arsyetimin e vetëm: derisa Jugosllavia të mbijetojë, qoftë edhe nën një etiketë të re, pretendimet e shqiptarëve të Kosovës për pavarësi nuk do të kenë ndonjë shans për sukses (Spasovska, 2013, f. 200). Por bashkësia Serbi - Mal i Zi, nuk zgjati shumë, sepse Mali i Zi do të ikte nga kjo bashkësi, që kishte mbetur si tendencë e fundit për t'u përdorur si argument se po ekzistonte RFJ-ja. Pavarësisht nga të gjitha, Kosova edhe pse pa status të përcaktuar, nuk mund të lihej mënjane politikisht. Në kontekst të procesit të paktit të stabilitetit për Kosovën u krijua një mekanizëm i veçantë që njihej si Mekanizmi Përcjellës i Stabilizim Asocimit (MPSA). Ky mekanizëm i krijuar nga BE-ja ka hyrë në fuqi në mars të vitit 2003, për të shërbyer si mekanizëm kryesor në dialogun në mes të Kosovës dhe Komisionit Europian, në kuadër të procesit të Stabilizim-Asociimit. Ky mekanizëm ka funksionuar në dy nivele: në formë të dialogut politik duke u mbajtur mbledhje plenare të bashkëkryesura nga autoritetet më të larta qeveritare të Kosovës dhe Komisionit Europian. Këtu diskutohen arritjet në përmbushjen e Partneritetit Europian dhe arrihet pajtimi për periudhën vijuese. Pastaj edhe në formë të dialogut teknik ku

zhvillohen mbledhje sektoriale për 6 sektorë: qeverisja e mirë, ekonomia, tregu i brendshëm, inovacioni dhe kohezioni social, infrastruktura dhe bujqësia e peshkataria.

Mekanizmi Përcjellës i Stabilizim Asocimit tregon trajtimin e ndryshëm që i bëhet Kosovës krahasuar me shtetet e tjera të ish-Jugosllavisë, si p.sh. Maqedonia. Kosova shumë më vonë hyn në raporte kontraktuese me BE-në. Kosova ka hyrë në marrëdhënie kontraktuese me BE duke nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit. Ky dokument është nën dosjen Interinstitutional file: 2016/0095 (NLE), të datës 02 tetor, 2015. Marrëveshja e Stabilizim Asociimit në mes të BE-së dhe Kosovës, ka hyrë në fuqi me datë 1 prill 2016 mes këtyre palëve: Marrëveshja e Stabilizim Asociimit në mes të Bashkimit Europian dhe Komunitetit Europian për Energji dhe Atom, si njëra palë dhe, nga ana tjetër: Kosovo*, si palë tjetër (*ky përcaktim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve për status dhe është në linjë me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit dhe me Opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë lidhur me Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës). Siç shihet nga këtu simboli asterisk (*) tregon se institucionet e Bashkimit Europian mbajnë qëndrim neutral lidhur me statusin e Kosovës. Kjo pra tregon vetvetiu pozitën krejt të ndryshme nga vendet tjera të rajonit në procesin e integrimi. Asnjë shteti nga territoret e ish-Jugosllavisë nuk iu vu asteriksi apo fusnota. Asnjë shteti nga territoret e ish-Jugosllavisë nuk iu përcaktua si kusht definimi apo demarkacioni i kufijve shtetërorë me shtetet fqinje, përpos Kosovës. Ndaj asnjë shteti nga territoret e ish-Jugosllavisë institucionet e BE-së nuk mbajtën qëndrim neutral lidhur me qenësinë e tyre si shtete. Nuk është asnjë shtet nga territoret e ish-Jugosllavisë që nuk është njohur nga shtetet anëtare të BE-së. Një kusht që i ishte vënë vetëm Kosovës (demarkacioni me Malin e Zi), e destabilizoi Kosovën dhe krijoi tensione të jashtëzakonshme. Një qeveri madje u rrëzua

pikërisht nga pamundësia e ratifikimit të marrëveshjes për demarkacionin me Malin Zi. Këso kushti nuk i ishte vënë asnjë shteti tjetër dhe madje nuk iu vu Republikës së Serbisë, e cila nuk besohet t'i ketë definuar kufijtë me shtetet përreth. Dhe kushti i demarkacionit ishte si një parakusht i rëndësishëm për liberalizimin e regjimit të vizave në zonën Shengen për qytetarët e Kosovës. E për qytetarët e Republikës së Serbisë liberalizimi i vizave është në jetë që para disa vitesh.

Që nga shpallja e pavarësisë së vet në vitin 2008 Kosova e ka bërë integrimin europian një ndër objektivat kryesore të politikës së jashtme. Shumica e qytetarëve janë gjithashtu mbështetës të integrimëve në BE ku 93% të popullatës është në favor të asaj që Kosova të bëhet shtet anëtar i BE. (Prishtina Institute of Political Studies)

Përshkrimi i mëposhtëm i nenit 49 të Traktatit të Bashkimit European na drejton më shumë te fakti se integrimi i Kosovës është më shumë problem politik, sesa problem juridik. Ky nen specifikon se:

cilido shtet europian që respekton vlerat që i referohen nenit 2 dhe që është i përkushtuar të promovojë ato dhe të konkurrojë për t'u bërë anëtar i Unionit; Parlamenti European dhe parlamentet nacionale duhet të njoftohen me këtë aplikim. Shteti aplikant duhet t'ia adresojë kërkesën e vet Këshillit, i cili duhet të veprojë me unanimitet pas konsultimit me Komisionin dhe pas marrjes së miratimit nga Parlamenti European, i cili duhet të veprojë me shumicë absolute nga anëtarët që e përbëjnë atë (European Policy Center and Group for Legal and Political Studies).

Kështu, neni 49 ndërton tre kritere në mënyrë eksplicite të cilat një shtet duhet t'i plotësojë në mënyrë që të jetë i zgjedhshëm që të konkurrojë për anëtarësim në BE.

Së pari, shteti duhet të jetë 'shtet europian'. E dyta, aplikanti duhet të respektojë dhe të përkrahë vlerat e përcaktuara në nenin 2 që do të thotë: respektimi i dinjitetit njerëzor, liria, demokracia, barazia dhe sundimi i ligjit, respektimi i të drejtave

të njeriut, përfshirë të drejtat që i përkasin minoriteteve dhe respektimi i shoqërisë pluraliste si dhe jodiskriminimi, toleranca, drejtësia dhe solidariteti e barazia në mes burrit dhe gruas. E treta, aplikanti duhet t'i kënaqë kushtet e BE-së për të qenë i zgjedhshëm që i referohen kritereve të Kopenhagës. Megjithatë, këto nuk janë në mënyrë eksplicite në Traktate dhe mund teknikisht të bëhen çështje e interpretimeve politike dhe ndryshimeve (European Policy Center and Group for Legal and Political Studies).

Analiza e këtij neni në mënyrë joemocionale do të tregojë nëse institucionet e BE-së sikundër edhe pesë shtetet që nuk e kanë njohur Kosovën, po veprojnë krejtësisht në përputhje me nenin e cituar.

Nga një analizë sipërfaqësore e raporteve në Ballkan, një term i nxjerrë nga Srdja Popoviç (akademik malazez) del sikur të mbështetet nga të gjithë. Ky term njihet si “stabilitokracia” (www.economist.com/news/europe), sipas të cilit supozohet se dikujt i duhet vetëm qetësia në rajon dhe ajo mund të ruhet duke përkrahur elitat ekzistuese, të cilat për arsye të ndryshme, këtë qetësi edhe e sigurojnë. E qetësia në rajon sipas këtij termi mund të ruhet duke bashkëpunuar me elitat ekzistuese politike, të cilat në rajon nuk janë shquar të kenë qenë të pastra nga korrupsioni dhe nga keqpërdorimet e pushtetit. Kjo qetësi, përmes stabilitokracisë, mund të ketë efekte afatshkurtëra, por në asnjë mënyrë nuk mund të sigurojë qëndrueshmëri dhe stabilitet. Bashkëpunimi dhe veprimi me stabilitokracinë është në kundërshtim me synimet afatgjata dhe me vlerat e promovuara nga dokumentet e rëndësishme të BE-së ku sundimi i ligjit do të ishte kyç. Por, a mund të sigurohet sundimi i ligjit përmes stabilitokracisë, kjo është çështje që duhet të zgjidhet në kohërat që po vijnë. Me elita politike të korruptura proceset edhe mund të sigurojnë paqe të përkohshme, por jo të qëndrueshme.

Akademiku malazez duke folur për stabilitokracinë ka folur për të gjitha vendet e Ballkanit duke mos përfshirë ndonjë nga këto vende. Se a mund të përdoret termi stabilitokraci për Kosovën dhe në ç' masë, kjo mbetet për t'u parë gjatë kohërave që po vijnë, kur pritet që të plotësohet kushti i luftimit të korrupsionit dhe krimit të organizuar, që i është vënë Kosovës si kusht i fundit për liberalizim të vizave pas votimit të demarkacionit të kufirit me Malin e Zi. Në anën tjetër, nëse institucionet e BE-së vazhdojnë të mbajnë status neutral ndaj statusit të Kosovës, kjo nuk i kontribuon zhvillimeve pozitive në Ballkan dhe në Kosovë. Kjo pozitë neutrale vetëm sa mund të përdoret edhe më tutje nga vendet që nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës si argument shtesë që të vazhdojnë me mosnjohje. E këto vende pavarësisht problemeve të tyre të brendshme duke mos njohur pavarësinë e shtetit të Kosovës, nuk besohet se veprojnë në frymën e qëllimeve të BE-së. Këto shtete jo vetëm që do të duhej ta njihnin pavarësinë e Kosovës, por ato duhet edhe të vetëpërmbahen nga deklaratat e zyrtarëve shtetërorë që shprehin kundërshtim ndaj pavarësisë. Deklaratat e tilla nuk janë në asnjë pikë në përputhje me traktatet e BE-së dhe me qëllimet e demokracive perëndimore.

Përfundime

Angazhimi i Bashkimit Europian dhe i organizatave e mekanizmave tjerë, ka qenë i rëndësishëm për paqen dhe stabilitetin në rajon. I rëndësishëm së njëjtë ka qenë edhe për Kosovën. Por, sikur të kishte qenë i intensitetit dhe i përmbajtjes së njëjtë edhe për Kosovën, edhe të arriturat në Kosovë do të kishin qenë më të mëdha, sikundër që pasojat do të kishin qenë më të vogla. Vonesat në veprime jo rrallë edhe hezitimi për parandalim të presionit dhe të dhunës, shkaktonin thellim të krizës dhe zgjerim konfliktesh. Mospërfshirja e

Kosovës në konferencat si e Londrës apo e Daytonit, tregon pos tjerash se nuk ekzistonte një politikë unike ndaj konfliktit, se kishte mospajtime në mes vetë shteteve anëtare, siç kemi edhe sot kur pesë shtete anëtare ende nuk e kanë njohur shtetin e Kosovës, sikundër që institucionet e BE-së mbajnë pozitë neutrale karshi statusit të Kosovës. Trajtimi i Kosovës nga një pozitë neutraliteti nuk është treguar i suksesshëm as për vetë Bashkimin Europian. Mosnjohja e pavarësisë nuk i ka ndihmuar procesit të demokratizimit të Ballkanit dhe as procesit të përgatitjes së Ballkanit për të qenë pjesë përbërëse e BE-së. Kjo politikë e pesë shteteve të BE-së është diskriminuese ndaj Kosovës sepse një shtet dhe një popull nuk gëzon të drejtën e njohjes së shtetësisë, e cila nuk mund të kontestohet. Pavarësia e Kosovës dhe shtetësia e saj është fakt që duhet respektuar përpos tjerash edhe nga shkaku se shteti i Kosovës është garantues i paqes dhe stabilitetit në Ballkan. Pavarësisht angazhimit që ka ndryshuar për nga intensiteti dhe përmbajtja në etapa të ndryshme, Kosova nuk do të ishte çliruar dhe nuk do të ishte shtet sovran dhe i pavarur.

Referencat

Bytyçi, E. (2012). *Diplomacia imponuese e NATO-s në Kosovë*. Tiranë: Instituti i studimeve të Europës Juglindore.

Desmond, D. *Historia e Integritit Europian*. Tiranë: AIIS për botimin shqip, (pa vit të botimit),

Dufour, P. (2010). *Kosova – Paqja e shpërfillur*. Prishtinë: Rozafa.

Fontaine, P. (2017). *Europe in 12 Lessons*, European Commission, Luxembourg: Publications Office of the European Union.

Zahiti, B. (2013) *E Drejta Europiane*. Botimi i tretë. Prishtinë: Olymp.

Shaw, M.N. (2003). *International Law*. Fifth edition. Cambridge: Cambridge University Press,

Miškulin, I.(2013). *Europska zajednica, jugoslavenska kriza i oružani sukob u Hrvatskoj. 1990.-1992.*

(www.slideserve.com/clare/europska-zajednica-jugoslavenska-kriza-i-oru-ani-sukob-u-hrvatskoj-1990-1992 - qasur me 28.03.2018).

Petritsch, W. & Pichler, R.(2002). *Rruga e gjatë në luftë – Kosova dhe bashkësia ndërkombëtare 1989 -1999*. Prishtinë: Koha.

Vucetic, S. (2001). *The Stability Pact for the South Eastren Europe as a Security Community-Building Institution*. Vol II, Nr.2, Southeast European Politics: pp.109-134.

European Policy Center and Group for Legal and Political Studies, (2017) *Kosovo's EU candidate status: a goal within reach?* Discussion paper, Brussels.

Forum 2015 – KFOS (2013) Operational project, *Kosovo - EU Relations: The history of Unfulfilled Aspirations? Lost opportunities in Kosovo's Duropean integration Process*, Prishtinë.

Prishtina Institute of Political Studies (2016), "*Citizens' general knowledge and perception on SAA*", PIPS Policy Report Declaration on the Guidelines on the Recognition of the New States in Eastern Europe and in the Soviet Union... was issued by the the EC Foreign Ministers meeting in Brussels on December 16,1991.

Webliografia

About the ICTY, (n.d.). Marrë nga:
<http://www.icty.org/en/about>.

http://www.europarl.europa.eu/summits/kol2_de.htm, marrë nga Bashkim I.Zahiti, E Drejta Europiane, Botimi i tretë, Olymp, Prishtinë, 2013, fq.199).

<http://www.emins.org/sr/dokumenti/downloads/ostalo/pa-kt-za-stabilnost.pdf> (qasur me 30.03.2018).

Spasovska V. Kunststaat im Interesse der EU, me 04.02.2004 në Deutsche Welle:

<http://www.dw.de/kunststaat-im-interesse-der-eu/a-771277>, cituar nga: Bashkim I.Zahiti, *E Drejta Europiane*, Botimi i tretë, Prishtinë, Olymp, 2013, fq.200.

www.economist.com/news/europe/21724414-some-call-it-stabilitocracy-others-call-it-way-things-have-always-been-west-backs-balkan - cituar nga Bashkim Rrahmani, ICES-17, 6th International Conference on European Studies-Local, Regional and Global Governance.(2017) Proceedings Book, Epoka University.